

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 20617/23

GERD GJINARARI KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 17 mars 2026 si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *kryetare*,

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit*,

Në lidhje me:

kërkesën (nr. 20617/23) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 16 maj 2023 nga një shtetas shqiptar, z. Gerd Gjinarari (“kërkuesi”), i cili ka lindur në vitin 1974, banon në Tiranë dhe u përfaqësua nga z. A. Saccucci, dhe znj. G. Borgna, avokatë, të cilët e ushtrojnë profesionin në Romë;

vendimin për të njoftuar mbi kërkesën qeverinë shqiptare (“Qeveria”), përfaqësuar nga Agjenti i saj, z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

konstatimet e palëve;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Kërkesa ka të bëjë me procedurat për kërkesën e kërkuesit për lirimin e tij të parakohshëm nga burgu.

2. Në vitin 1997 dhe 2002, gjykatat italiane e shpallën kërkuesin fajtor për falsifikim të dokumenteve, vrasje në rrethana rënduese, mbajtje të armëve të zjarrit, prodhimin dhe tregtimin e narkotikëve dhe kryerjen e krimeve nga një grup i armatosur, dhe e dënoi atë me burgim të përjetshëm.

3. Më 10 mars 2014, Gjykata e Rrethit Tiranë njohu vendimet e gjykatave italiane. Më 24 nëntor 2014, kërkuesi u transferua në Shqipëri për të vuajtur dënimin me burgim të përjetshëm.

4. Më 14 shkurt 2019, Gjykata e Rrethit Korçë e pranoi kërkesën e kërkuesit për lirim të parakohshëm, dhe kërkuesi u lirua. Megjithatë, mbështetur në apelimin e prokurorisë, më 26 qershor 2019, Gjykata e Apelit Korçë e prishi vendimin duke e rrëzuar kërkesën e kërkuesit.

5. Më 6 gusht 2019, kërkuesi paraqiti një apelim pranë Gjykatës së Lartë që u rrëzua më 14 qershor 2022.

6. Më 14 nëntor 2022, kërkuesi paraqiti një apelim kushtetues që u shpall i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese më 16 janar 2023, pasi ishte dorëzuar jashtë afatit 4-mujor, duke e nisur numërimin që prej datës së vendimit të Gjykatës së Lartë.

7. Pas lirimit të tij nga burgu në vitin 2019, kërkuesi është i arratisur, dhe vendndodhja e tij mbetet e paditur.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Neni 6 § 1 i Konventës

8. Kërkuesi u ankua për shkelje të së drejtës së tij për t’iu drejtuar një gjykate, për shkak të përlllogaritjes nga Gjykata Kushtetuese të afatit kohor për paraqitjen e një ankesë kushtetuese.

9. Gjykata përsërit se shqyrtimi i kërkesave për lirim të parakohshëm nga paraburgimi, ose i çështjeve në lidhje me mënyrën e ekzekutimit të një dënimi me burgim, nuk i përket fushës së veprimit të nenit 6 § 1 të Konventës. Një shqyrtim i tillë nuk ka të bëjë as me përcaktimin e një “akuze penale” dhe as me përcaktimin e “të drejtave dhe detyrimeve civile”, sipas interpretimit të këtij neni (shih, midis të tjerësh, *Enea kundër Italisë [DHM] nr. 74912/01, § 97, GJEDNJ*

2009; *Boulois kundër Luksenburgut [DHM]* nr. 37575/04, § 87, GJEDNJ 2021; dhe *Dybeku kundër Shqipërisë* nr. 41153/06, § 55, 18 dhjetor 2007, të gjitha me referenca të tjera).

10. Rrjedhimisht, kjo ankesë është e papajtueshme *ratione materiae* me parashikimet e Konventës, sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a), dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 § 4.

B. Ankesa të tjera

11. Këto ankesa nuk iu komunikuan Qeverisë së paditur, por ato janë të papranueshme për arsyet e paraqitura në vijim.

12. Në mbështetje të neneve 3 dhe 7 të Konventës, kërkuesi u ankua se parashikimeve të Kodit Penal të Shqipërisë që rregullonin lirimin e parakohshëm iu mungonte qartësia dhe parashikueshmëria, se të burgosurit me burgim të përjetshëm bëheshin të ligjshëm për lirim të parakohshëm, vetëm pasi të kishin vuajtur tridhjetë e pesë vjet, se ligji parashikonte mundësinë e liritimit të parakohshëm, pasi të ishte arritur rehabilitimi, por pa rregulluar programe individuale të rehabilitimit dhe, se në rastin e kërkuesit, kishte pasur një zbatim prapaveprues të dispozitave të Kodit Penal, që kishin të bënin me lirimin e parakohshëm.

13. Gjykata thekson se kërkuesi ishte liruar në vitin 2019, pasi gjykata e shkallës së parë kishte pranuar kërkesën e tij për lirim të parakohshëm. Që prej atij momenti, vendndodhja e tij mbetet e panjohur, edhe pse në formularin e kërkesës së tij ai kishte listuar një adresë në Tiranë si vendbanimin e tij. Në këtë mënyrë, pasi gjykata e apelit rrëzoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, kërkuesi nuk u kthye të vuante pjesën e mbetur të dënimit të tij.

14. Gjykata vlerëson se garancitë, sipas neneve 3 dhe 7 të Konventës për mundësinë e liritimit të të burgosurve me burgim të përjetshëm, zbatohet vetëm për personat që tashmë janë në burgim dhe po shërbejnë dënimin e tyre. Qëllimi i këtyre garancive është që të burgosurve që vuajnë dënimin me burgim të përjetshëm t'u jepet mundësia të bëjnë kërkesë për lirim (krahaso me parimet e paraqitura në *Murray kundër Holandës [DHM]* nr. 10511/10, §§ 99-104, 26 prill 2016). Këto garanci humbasin kuptimin për personat që janë në gjendje të lirë. Gjykata vëren se, në çështjen konkrete, pavarësisht ekzistencës së vendimeve gjyqësore të vlefshme që e dënojnë kërkuesin me burgim të përjetshëm dhe që më pas rrëzojnë lirimin e tij të parakohshëm, ai nuk është i ndaluar fizikisht dhe është i arratisur nga drejtësia.

15. Rrjedhimisht, këto ankesa janë qartazi të pambështetura dhe duhet të rrëzohen në mbështetje të nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 9 prill 2026.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Úna Ní Raifeartaigh
KRYETARE